

“BEJTAGA 2023” SH.P.K

STATUT

Më 24. 08. 2023

Kavaje , Shqipëri

**KAPITULLI I : Emri, Forma Ligjore, Selia Qëndrore Dhe Kohëzgjatja**

## Neni 1. Emri i Shoqërise

1.1 Emri i Shoqërise eshte “*BEJTAGA 2023*” (“Shoqëria”). Në të gjitha dokumentet, reklamat dhe botimet e lëshuara nga Shoqëria , emri i saj duhet të mbrohet ose të ndiqet nga:

- (i) Fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “Sh.P.K”

## Neni 2. Forma Ligjore e Shoqërise

2.1 *BEJTAGA 2023* është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, organizuar në përputhje me legjislacionit Shqiptar dhe me dispozitat e këtij Statuti (“Statuti”) dhe cdo dokument tjeter pasues.

## Neni 3. Selia Qëndrore e Shoqërise

3.1 . Tirane Kavaje KAVAJE Lagija nr.3, Bulevardi "Josif Budo", objekt 5 - katesh, kat i pare, godina nr.19.

Shoqëria rezervon të drejtën për të ndryshuar selinë qëndrore në një adresë tjeter.

## Neni 4. Kohëzgjatja e Shoqërisë

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një afat kohor të pacaktuar.

## **KAPITULLI II: Objekti i Shoqërisë**

### Neni 5. Objekti i aktiviteteve të Shoqërisë

5.1 Objekti i aktiviteteve të Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- Tregtim artikujt te duhahnit (tabachino), bar etj.

## Neni 6. Amendimet

6.1 Ortakët rezervojnë të drejtën të amendojnë qëllimin e aktiviteteve të Shoqërisë në cdo kohë, sic përkufizohet në këtë Statut.



### Kapitulli III :Kapitali

#### Neni 7. Kapitali i Shoqërisë

7.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga një kutotë e vetme:

- (i) Z. Ali Bejtaga zotëruesh i kësaj kuote, prej 100%, me vlerë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

7.2 Kontributi i Ortakut/ve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme dhe/o se të drejta). Kapitali i shoqërisë është në para dhe plotësisht i shlyer.

#### Neni 8. Zvogëlimi ose zmadhimi i kapitalit

8.1 Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë mund të miratojë vendime mbi zmadhimin dhe/o se zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në përputhje me kërkesat e detyrueshme të legjislacionit Shqiptar.

8.2 Kapitali do të zmadhohet me kontribute me para në dorë ose në natyrë, duke përfshirë gjithashtu rezervat dhe dividentët e pashpërndarë të shoqërisë.


8.3 Nëasnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

8.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 9. Transferimi i kapitalit

9.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- (i) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- (ii) shit-blerjes;
- (iii) trashëgimise;



(iv) dhurimit;

(v) cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në Statut.

9.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 10. Të Drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve të Shoqërisë

10.1 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga një Ortakët i Shoqërisë .

10.2 Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga ortakët, me të drejtën e 1 ( një ) vote secili në Asamblenë e Përgjithshme , duke përfaqësuar secili përqindjen e kapitalit sipas pikës 7.1 të këtij Statuti dhe duke i dhënë të drejtën për tu zgjedhur ose të zgjedhin organet drejtuese , të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e përfitimeve të Shoqërisë ( në përputhje me këtë Statut dhe dispozitat ligjore ), si dhe të drejta të tjera të parashikuara në këtë Statut

10.3 Ortakët e Shoqërisë do të marrin informacion nga administrata e Shoqërisë në çdo kohë , pa kërkesë me shkrim , të gjithë informacionin dhe të dhënat lidhur me veprimtarinë e Shoqërisë në çdo kohë , duke përfshirë të drejtën për të kontrolluar dokumentet dhe të dhënat e Shoqërisë .

10.4 Detyrimet e Shoqërisë garantohen nëpërmjet kapitalit të saj dhe Ortakët e Shoqërisë mund të jenë përgjegjës vetëm brenda kufirit të vlerës së kapitalit ; Ortakët e Shoqërisë nuk kanë përgjegjësi përtëj kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë ( përvëç garancive personale të dhëna hua për detyrime të tjera ).

10.5 Shoqëria nuk është përgjegjëse për borxhet dhe / ose detyrime të tjera personale të Ortakëve të Shoqërisë .

#### **Kapitulli IV : Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

Neni 11 Kompetencat dhe Vendimet e Ortakëve të Shoqërisë

11.1 Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga një Ortakët është organi më i lartë vendim - marrës i Shoqërisë , i cili merr vendime mbi aktivitetin e saj dhe mbi politikat ekonomike dhe tregtare .

11.2 Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme :

- ( a ) të miratojë strukturën organizative të Shoqërisë ;
- ( b ) të emërojë dhe të shkarkojë Administratorin ( et ) e Shoqërisë ;
- ( c ) të miratojë vendime për amendimin e Statutit për ndryshimin e formës ligjore të Shoqërisë ; ose
- ( d ) të marrë çdo vendim tjetër lidhur me çështjet e Shoqërisë , përveç nëse parashikohet ndryshe në Statut .

11.3 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve , i cili ruhet në Selinë Qendrore të Shoqërisë .

11.4 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime qarkulluese me shkrim , të cilat bëhen të ditura nëpërmjet postës elektronike të Administratorit .

11.5 Asambleja e Përgjithshme mund të udhëzojë me e - mail Administratorin në çdo kohë për çështjet lidhur me veprimtarinë e Shoqërisë në përgjithësi dhe këto udhëzime janë detyruese për Administratorin e Shoqërisë .

11.6 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike . Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vandin , datën , orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve , jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë .

11.7 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 11.6 të këtij nenit , ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord , për të marrë vendime , pavarësisht mosrespektimit të kësaj procedure .

11.8 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme , në bazë të një Autorizimi / Prokurë e Posacmë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë .

11.9 Administratori i Shoqërisë nuk mun të veprojë si përfaqësues i Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme .



11.10 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme , e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite .

## Kapitulli V : Administratori i Shoqërisë

### Neni 13. Administratori

13.1 Shoqëria administrohet nga 1 ( një ) Administrator , i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te palët e treta dhe është përgjegjës për çështjet ditore të Shoqërisë , duke iu nënshtruar kufizimeve të Statutit dhe legjislacionit të zbatueshëm

13.2 Administratori i parë i Shoqërisë është emëruar në Akt - Themelimin e Shoqërisë dhe do të jetë Z. Ali Bejtaga , shtetas Shqiptar , lindur më 13/10/1960 , në Kavaje , mbajtës i Kartës ID- së me numer G01013027F .

13.3 Afati i emërimit të Administratorit është 5 ( pese ) vjet nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit ( " QKB " ) , me të drejtë riemërimi .

13.4 Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme . Me pranimin e emërimit të tij , Administratori pranon se marrëdhënia e tij me Shoqërinë është në bazë të mirëbesimit . Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë të shkarkojë Administratorin nga detyra e tij , në çdo kohë për çdo arsy .

13.5 Kompetencat e Administratorit për përfaqësimin e Shoqërisë përfshijnë :

- (i) Qëllimin që Asambleja e Përgjithshme të aprovojë çdo vendim për çështjet që janë në kompetencën Asamblesë së Përgjithshme ;



- (ii) Të administrojë biznesin e Shoqërisë duke implementuar politikat dhe planet e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme ;
- (iii) Të përfaqësojë Shoqërinë me palët e treta ;
- (iv) Të sigurohet që regjistrat dhe dokumentet e Shoqërisë të ruhen në mënyrën e duhur ; Të sigurojë dhe të nënshkruajë pasqyrat vjetore të llogarive dhe llogarive të kosoliduara , si dhe raportin e performancës së bashku me propozimin e Asamblesë së Përgjithshme lidhur me shpërndarjen e dividentëve ;
- (v) Të krijojë paraprakisht një sistem paralajmëruesh lidhur me ngjarje të cilat mund të rrezikojnë ekzistencën dhe performancën e Shoqërisë ;
- (vi) Të dorëzojë të dhënat për regjistrim në QKB atëherë kur duhet ;
- (vii) T'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme lidhur me implementimin e politikave të biznesit dhe kryerjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për Shoqërinë ;
- (viii) Të kryejë detyra të tjera sipas udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe / ose në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm , herë pas here ;

### 13.6 Përgjegjësitë e Administratorit

- (i) Administratori është përgjegjës individualisht , ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve , për shkelje të ligjeve , për shkelje të statutit , apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë ;
  - (ii) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithsme që i sjellin dëm shoqërisë , i ngarkohen Administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen , për ta përballuar në mënyre individuale ;
  - (iii) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë , sipas neneve 14 , 15 , 17 e 18 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " .  
    - të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi , duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrë ;
    - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita ;
    - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet , për të cilat merret vendim ; të vlerësojë me përgjegjësi çështjet , për të cilat merret vendim ;
    - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit , prezent apo të mundshëm , të interesave personale me ata të shoqërisë ;
    - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm .
  - (iv) Administratori , gjatë kryerjes së detyrave të tij , përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim , që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë
- 

tregtare , me përjashtim të rasteve kur , në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse , veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim .

- (v) Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale , sipas pikave ( i ) e ( ii ) të këtij neni , është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet , që rrjedhin nga kryerja e shkeljes , si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta . Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara . Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator , ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare .
- (vi) Në mënyrë të veçantë , por pa u kufizuar , Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara , nëse , në kundërshtim me dispozitat e ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " , kryen veprimet e mëposhtme :
- u kthen Ortakëve kontributet ;
  - u paguan Ortakëve interesa apo dividendë ;
  - u shpërndan aktivet shoqërisë ;
  - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare , kur , në bazë të gjendjes financiare , duhej dhe mund të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet ;
  - jep kredi
- (vii) Pervec padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht Administratorit, Ortaket individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kunder Administratorit, Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë Të demit që i është shkaktuar shogërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse eshtë e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë së Përgjithshme nuk mund te ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër Administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

13.7 Administratori do të mbikëqyrë dhe do të sigurohet që zyrtarët, agjentët, punemarresi, aludituesit dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe nëinteresin me të mirë të Shoqërisë.

13.8 Bazuar në udhëzimet dhe vendimin me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, i histratori Ort mund të lëshojë Autorizim/Prokurë të Posaçme për individë të tretë, për të Vepruar në emër të tij dhe të përfaqësojnë Shoqërinë te palët e treta, për çështje specifikee per tu adresuar për vendim të Asamblesë së Përgjithshm.

13.9 Administratori do të kërkojë udhëzimet dhe miratimin me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, për të lidhur çdo kontratë me klientët, për çdo kontratë me shitësit lokal, si dhe çdo transaksion që kalon 500,000 Lekë.

## **Kapitulli VI: Administrimi finansiar dhe Kontabiliteti i Shoqërisë**

Neni 14. Audituesit

14.1 Asambleja e Përgjithshme do të enmërojë një auditues Ose të bëjë auditimin e Shoqërisë në perputhje me legjislacionin Shqiptar

Neni 15. Viti Financiar

15.1 Viti financiar fillon më 01 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të Shoqërisë.

Neni 16. Kontabiliteti

16.1 Shogeria do të mbajë Kontabilitetin në monedhën Shqiptare (Lek) dhe do të mbajë pasqyrat e saj dhe llogaritë e dividentëve në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

16.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentet kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithë-vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakëve.



16.3 Në përfundim te kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjertjen e rezultatit te bilancit finansiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezojë në kohë Ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

#### Neni 17. Shpérndarja e Dividentit

17.1 Dividenti i Shoqërisë është përcaktuar në bazë të pasqyrave të miratuara nga Asambleja e Pergjithshme. Shpérndarjae dividentit miratohet nga Asambleja c Përgjithshme,

17.2 Shoqëria duhet të krijojë një fond rezervë nga dividenti vjetor, sipas parashikimeve ligjore te legjislacionit Shqiptar për fondet e rezervës ligjore.

#### Neni 18. Prishja dhe likuidimi


18.1. Shpérndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- (i) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- (ii) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- (iii) me hapjen e procedurave të falimentit;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë tregtare në përputhje me piken 3, nen 43i ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 Për Qendrën Kombetare të Biznesit", i ndryshuar;
- (v) me vendim gjykatë;

18.2. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) dhe/ose disa likuidatorë dhe duke shnuar në çdo dokument të nxjerë prej tij/saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër

18.3. Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimenti.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.



18.5. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mundt'i drejtohet gjykalës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19. Riorganizmi i Shoqërisë (bashkimi-ndarja)

19.1. Shoqëria mund të ndahet/bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 9901, datë 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare"

## Kapitulli VII: Të ndryshme

Neni 20. Dispozita Kalimtare

20.1 Për cdo cështje që nuk rregullohet në mënyre specifike nga ky Statut do të aplikohet Ligji për: "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare". Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Ortaku Themelues:



Z. Ali Bejtaga



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Z. Ali Bejtaga". The signature is fluid and cursive, with the "Z." at the top left, followed by "Ali" and "Bejtaga" stacked vertically.